

Nr. 43-218
Br. No.
Data 29.03.2007
Datum Date



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT



MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL
MINISTARSTVO ADMINISTRACIJE LOKALNE SAMOUPRAVE
MINISTRY OF LOCAL GOVERNMENT ADMINISTRATION

Bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/19 "Mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës", Neni 1.3 (d), Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2005/15 "mbi ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/19 "Mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës", shtojca XIV pika (d) dhe (g), Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/45 "Mbi Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë" neni 11.3 pika (j) dhe neni 39, bazuar në Marrëveshjen e Mirëkuptimit të lidhur në mes të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Udhëzimin Administrativ 2007/2 të nënshkruar nga Ministri i MEF-it dhe MAPL-së "Për të Hyrat Vetanake të Komunave", Ministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal nxjerrë këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. MAPL 2007/03

"PËR CAKTIMIN, NGARKESËN DHE MBLEDHJEN E PAGESAVE PËR REGJISTRIMIN VJETOR TË AUTOMJETEVE NË TERITORIN E KOMUNAVE

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është të sqarojë veprimet dhe procedurat që duhet të ndërmerren nga komunat, në mënyrë që të marrin pjesë në sistemin për mbledhje të pagesave për regjistrimin vjetor të automjeteve të përcaktuara në Marrëveshjen e Mirëkuptimit në mes të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB). Këto pagesa janë të hyra burimore komunale si kompensim i pjesshëm për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e rrugëve komunale si dhe ofrimin e lehtësirave për parkim të automjeteve.

Neni 2 Caktimi i pagesave

- 2.1 Në mënyrë që të marrin pjesë në sistemin për mbledhjen e pagesave të caktuara Kuvendet Komunale duhet të nxjerrin rregullore lokale për caktimin e pagesave vjetore për secilin automjet të regjistruar në territorin e komunës, si dhe të caktojnë shkallën e pagesave, në pajtim me Udhëzimin Administrativ si dhe kushtet tjera, të rëndësishme për implementimin e Rregulloreve. Komunat të cilat nuk lëshojnë rregullore lokale të duhura nuk mund të marrin pjesë në sistemin e mbledhjes, të vendosur në mes të MAPL-së dhe MPB-së.
- 2.2 Pagesat vjetore komunale për automjete duhet të caktohen në shkallë të njëjtë për të gjitha komunat. Për të marrë pjesë në programin e mbledhjes, shkallët e njëjta për një automjet që peshon deri në 3.5 tonë duhet të jetë 10 € (dhjetë euro), ndërsa për automjete mbi 3.5 tonë duhet të jetë 20 € (njëzet euro).

Neni 3

Kërkimi i lejeve komunale për automjete dhe pagesave për parkim

- 3.1 Ngarkesat komunale për pagesat vjetore për regjistrimit të automjeteve në territorin e komunës do të bëhen gjatë regjistrimit të obliguar vjetor apo ri-regjistrimit të automjeteve në MPB.
- 3.2 Sistemi i mbledhjes, i pajtuar në mes të MAPL-së dhe MPB-së do të aktivizohet dhe funksionalizohet pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit ndërmjet MPB-së dhe MAPL-së.
- 3.3 Komunitat nuk do të mund të përjashtojnë regjistrimin e automjeteve nëse vendosin të marrin pjesë në sistemin e mbledhjes, të pajtuar në mes të MAPL-së dhe MPB-së.

Neni 4

Mbledhja e pagesave për regjistrimin vjetor të automjeteve në territorin e komunës

- 4.1 Për të marrë pjesë në sistemin e mbledhjes të pajtuar në mes të MAPL-së dhe MPB-së, Komunitat duhet të hapin kodin e posaçëm të llogarive të tyre komunale zyrtare të hapura në Ministrinë për Ekonomi dhe Financa, në të cilat do të deponohen të gjitha pagesat për leje të automjeteve.
- 4.2 Komunitat duhet të përgatisin formularë të shumëpjesëshëm për pagesë, përkatësisht në katër kopje të cilat duhet t'i ofrohen regjistruarëve të automjeteve nga komunitat dhe përmes MPB-së, në mënyrë që t'ju lehtësohet mundësia qytetarëve të bëjnë pagesën në mënyrë të njëjtë si pagesat dhe ngarkesat tjera komunale. Këta formularë duhet të përfshijnë shumën, numrat e llogarisë, si dhe informatat tjera përkatëse.
- 4.3 Formularët për pagesa të përgatitura nga komunitat duhet të jenë në dispozicion të qytetarëve në Qendrat për Shërbime Komunale, Zyrrat Komunale dhe Zyrrat për regjistrimin e veturave. Qytetarët dhe regjistruarët e automjeteve mund t'i marrin këta formularë pa pagesë. Dëftesa do të lëshohet në katër kopje, një për pronarin e automjetit, një për Qendrën për Regjistrimin e automjeteve, një për komunitat si dhe një për bankën.
- 4.4 MPB do të kërkojë një kopje të autorizuar dhe autentike të formularëve komunal për të vërtetuar se pagesa vjetore për regjistrim të automjetit në territorin e komunës është paguar nga aplikuesit. Regjistruarët vendor në komunitat të cilët nuk mund të vërtetojnë të kenë bërë pagesën nuk do të ju lejohet t'i regjistrojnë automjetet e tyre, derisa t'i paraqitet Qendrës për Regjistrimin e Automjeteve dëshmia për bërjen e pagesës.

Neni 5

Shfrytëzimi i pagesave për regjistrimin vjetor të automjeteve në territorin e komunës

- 5.1 Komunitat pjesëmarrëse duhet të pajtohen që të hyrat nga pagesat vjetore për regjistrimin e automjeteve të regjistruara në territorin e komunës të shfrytëzohen për mirëmbajtjen dhe ndërtimin e rrugëve komunale dhe ndërtimin e vend-parkimeve.

- 5.2 Komunat pjesëmarrëse duhet të jenë në gjendje të ofrojnë vende të mjaftueshme parkimi pronarëve të automjeteve konform politikave transparente për investime kapitale të nxjerra nga kuvendet komunale.
- 5.3 Pas aprovimit të rregulloreve lokale, Komunat pjesëmarrëse duhet sa më parë t'i miratojnë planet për mirëmbajtje dhe ndërtim të rrugëve dhe të vend parkimeve, si pjesë e planeve të tyre hapësinore për qendrat urbane.

Neni 6
Raportimi nga komunat pjesëmarrëse

- 6.1 Komunat pjesëmarrëse do t'i raportojnë MEF-it me anë të raporteve të rregullta mbi të hyrat, përfshirë dhe të hyrat e inkasuar nga pagesa vjetore për regjistrimin e automjeteve në territorin e komunës.
- 6.2 MAPL-ja do të vlerësojë dy herë në vit përbushjen e detyrave të komunave, në kuptim të implementimit të këtij Udhëzimi Administrativ, si dhe do të sigurojë MPB-së listën e komunave pjesëmarrëse të kualifikuara, sipas nevojës dhe për shkak të ndryshimeve në aktivitetet komunale si dhe kualifikimet.


Neni 7
Përgjegjësitë

Kryeshefi Ekzekutiv i komunës është përgjegjës për kompletimin dhe dorëzimin e një letre zyrtare MAPL-së, përmes së cilës kërkohet përfshirja në procesin e mbledhjes, dhe sigurimin e të gjitha dokumenteve të nevojshme zyrtare për verifikimin e pajtueshmërisë me Udhëzimin Administrativ të MAPL-së, si dhe sigurimin e implementimit ligjor të sistemit të paraparë.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ do të hyjë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Ministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ministrit të MAPL-së dhe Ministrit të MPB-së.

Prishtinë 26.03.2007

Lutfi Haziri

Zëvendës Kryeministër dhe
Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal